

DOKUMENTA DHE MATERIALE

ZIAUDIN KODRA

POEMA «KENKAT E KRUIJES» E KOZMO SEREMBES

Kozmo Serembe, i nipi i poetit tonë të madh Zef Serembes, i njohur si lëvruer i poezisë dhe studimeve shqiptare, na ka lënë një poemë të gjatë epiko-lirike të tipit kalorsiak, prej njëzet e pesë këngësh.

Kjo vepër është frut i një pune të gjatë, të frymëzuar nga ndjenja atdhetare e autorit.

Sipas shënimit që mban në fund, vepra është përfunduar më 22 të dhjetorit 1937, në Milano, ku autori ushtronte profesionin e avokatit, por ka mbetur e pabotuar gjer më sot.

Duke ndjekur një traditë të njohur për letërsinë tonë të Rilindjes, Kozmo Serembe temën e veprës e ka marrë nga shekulli i madh i Skënderbeut.

Poema, si e tregon gjer diku dhe titulli, ka për subjekt rrethimin e Krujës nga Mehmeti i dytë.

Ajo nis, në këngën e parë, me një thirrje që poeti u drejton dallëndysheve, të cilavet u lutet t'i tregojnë për luftrat që kanë ndodhur «përrotullas» Krujës dhe për «të mëdhatë trimëri» të shqiptarëve.

Dallandisha që këndoni
Sypër Krujës pjot ulli,
U ju lutem të më thoni
Më të madhat trimëri,
Edhe ljuftat të mëdhátë
Që përrotullas ju patë. (I, 1)

Pastaj poeti i fton miqtë të mbushin kupat dhe ta dëgjojnë se do të këndojnë luftrat në mes të shqiptarëve dhe të turqvet, duke marrë rast kështu të na shpjegojnë në oborrin e Sulltanit në Adrianopol e të na paraqesë Sulltan Mehmetin të rrethuar me shkëlqim, tërë madhështi e salltanet në veshje, të egër e të etur për luftë. Njerëzit që e rrethojnë dhe ata ia miratojnë qëllimet e tij për luftë.

Në mes të këtyre luftëtarëve është dhe Ballabani, që i ka fshehur Sulltanit një rob të çuditshëm, lëkurëkuq. Pa dhënë shpjegime për robin që intereson Sulltanin, poeti nis të tregojë kush është Ballabani:

Ballabani? E kush ë ky?
 Gjith ja thon' biri i Badherës
 Edhe u ljeu ndë Shkqipëri
 Prej çobanëra të derës
 Të Kastriotvet. Kje rrëmbier
 Nga Magjypët, çun i mier. (I, 17)

Gjërit e gjitonia e kërkuan e e kërkuan, por në pyll gjetën vetëm rrobat e tij të përgjakura, që magjypët i lyen me gjak kau për të humbur gjurmët. Gjithë kujtuan se e kish shqyer ujku, por ai u rrit me magjypët, mësoi me ta të vjedhë e dashuroi një magjype lesh-zezë. E zë lia dhe magjypët e lënë robin në udhë të madhe. Për fatin e tij e gjejnë tre kallojerë dhe e shërojnë. Harron magjypen dhe shkon në Turqi, ku hyn në shërbim të ushtrisë turke. (Barleti e paraqet Ballabanin bari nga Mati, që bie rob në dorë të turqve). Atje dëfton trimëri dhe arrin të bëhet njeri i afërt i Sulltanit.

Ndërkaq poeti na kthen prapë tek mbledhja me Sulltanin, ku Ballabani nis të tregojë se robin lëkurëkuq nuk e ka vjedhur, por e ka gjetur.

Robi sillet në skenë e me kërkesën e Sulltanit kallëzon historinë e tij e të vendit të tij të begatshëm e me njerëz të virtytshëm. Sulltani, për ta provuar trimërinë e tij, e vë të luftojë me një gjeorgjian. Fiton lëkurëkuqi e Sulltani e bën pashë e shok me Ballabanin. Ky i fundit gjen rast ta nxisë Sulltanin për të ndërmarrë një sulm kundër Krujës, që, si thotë Ballabani, i pret Turqisë udhën për në Romë, duke i kujtuar se si dështoi fushata e Sulltan Muratit, për të shtënë në dorë Krujën dhe se si ra ai vetë në ledhet e qytetit; se ka ardhur koha të nisen kundër Skënderbeut për të marrë gjakun e Sulltan Muratit.

Kekj Murati u heljëmua
 Edhe mjekërën e shklori:
 «Nëmë e kekje q'e për mua!
 Kjeni armat m'i permori!»
 Kjaiji i mjeri. O natë e shkretë,
 Afër Krujës u vra vetë.

Ndera e besa na shtrëngonjën,
 Zot i madh, t'i marrmi gjakun.
 Arbëreshët së guxonjën
 Ndë se ngrehemi bajrakun
 Sot që mbjodhtin për të vrrarë
 Më të mirët ljuftëtarë. (I, 98, 99)

Po Mehmeti ka frikë shpatën e Skënderbeut:

Shpata e Skandërit më mbanë
 Se të madha ka magji
 Gurët prej si djath të ri. (I, 100)

Ngrihet në mbledhje dhe renegati Ilo Prift Panariti dhe përkrah mendimin për t'i shpallur luftë Arbërisë, por trimi shqiptar Aladini, që është bërë turk pa e ditur, i zemëruar shan Ballabanin për tradhëti mu në sy të Sulltanit.

«Mirë e di... Po Ballabani
 Fjalëmadhi juve shtinë

Me akj shpat' që ka Sulltani
Për të rrahur Arbërinë.
Kjen i thoni e tradhëtarë,
Se harron e fys e farë». (I. 126)

Biri i Badherës ngrë shpatën i zëmëruar, por Aladini, si u kërcënohet të gjithëve, ikën e zhduket si erë.

Figurën e Aladinit poeti e ka marrë nga poezia popullore, ashtu si ka marrë dhe motive e personazhe të tjera të folklorit arbëresh si Milo Shinin, që haset që në këngën e parë të poemës, si dhe në rap-soditë, si shok armësh i Skënderbeut.

Edhe në këngën e dytë veprimi zhvillohet në Andrianopojë: Sulltani është i rrethuar nga njerëzit e tij, në mes të të cilëve edhe Ballabani. Të gjithë janë të tmerruar nga veprimet e Aladinit që ka shpëtuar i gjallë edhe ka ikur duke e marrë nën mbrojtje Minerva e Shqipërisë, ora e Malevet:

Aladhini ndënj i gjallë,
Se Menerva e Shkjypëris,
Ora e Maljëvet, me mallë,
Mbasi ë Nuna e trimëris,
Posi bir për krahu e mori
E nga syt e dheut e nxori. (II, 12)

Ora e maleve e bën Aladinin të paparë nga turqit, ndërsa vetë ai sheh forcat që po nis Sulltani kundër Skënderbeut. Duke qëndruar pranë Orës, Aladini mëson prej saj për luftrat e Skënderbeut kundër Sulltan Muratit si dhe për fatin e Dilës së bukur, që e kanë grabitur e zënë robe turqit gjatë një ekspedite në Vlorë.

Nga Adrianopoja, në këngën e tretë poeti na sjell në Shqipëri, pa na e caktuar vendin; nis të na flasë për Milo Shinin, shatër të Skënderbeut. Ai është luftëtar dhe këngëtar i zoti. Kështu përshkruhet heroi që në fillim të këngës:

Shatër është i Skanderbeut;
Ljozën shpatën me fukji
Jashta e mbrënda Mëmëdheut,
Jo, së gjëndet ndonjeri
Që si ky di të trehonjë,
Mbi lahutës të këndonjë. (III, 4)

Si në eposin kalorsiak, Milo Shini ka dashnoren e tij, që e ka emrin Irenë, po e thërresën Fanmirë. Atë e kanë dashur shumë trima, dhe Milo Shini e ka fituar si ka luftuar me shumë prej tyre. Është hapur lajmi se po vjen Sulltan Murati të shtrojë Shqipërinë. Skënderbeu e thërret Milo Shinin, dhe e porositi të shkojë të takojë të dashurën para se të nisë lufta, se ka lëshuar kushtimin:

E nga maljet vjen kushtimi
E përhapet gjatë e gjerë
Edhe zëmra zgjon këndimi
Malësorevet të vllërë:
«Vjen armiku si duhi,
Burr, ty vra, sa she' me sy. (III, 11)

Milo Shini niset dhe arrin tek Irena. Dy të dashurit ndahen dhe trimi i lë vashës për kujtim lahutën. Ditët kalojnë dhe Irena pret në dritare t'i kthehet «malli i saj». Pyet dallëndyshet e atoi përgjigjen se ia kanë parë trimin që bashkë me Shkënderbenë bën kërdrinë mbi turqit.

Pritja është e gjatë dhe Irena ngushëllohet duke kënduar me lahutën që ia ka lënë Milo Shini peng dashurie. Shumë princër vijnë dhe e kërkojnë Irenën për nuse, por ajo i refuzon se:

Milo Shinin dëshironte
Vasha, e besën së harronte. (III, 42)

Aqë më keq ajo pret me zëmërim një turk, që e kërkon duke i premtuar se do të këmbente besën e se do të shkonte bile të luftonte me Skënderbenë kundër turqve.

Trimëresha u zëmërua
Një baljestërezë e ngrehu
Duke thënë: «Të vret një grua
More turk e kjen!» ja shkrehu
Vasha e rrebtë: Turku iku.
Shif guxim që kishte armiku!» (III, 44)

Për episodin e Irenës dhe të Milo Shinit poeti është frymëzuar nga këngët popullore si ajo «E bukura, i varfëri dhe kali» e këngë të tjera që tregojnë se si vashat shqiptare e përbuzin turkun armik dhe mbajnë besën e fjalën e dhënë trimit që vete në luftë kundër turqve. Këtu poeti, si e ka zakon shpesh, e këput episodin e Irenës, pa e përfunduar dhe nëpërmjet një digresioni të gjatë na shpije prapë tek Aladini, që e la në këngën e II. Aladini merr pjesë në një festë pagane, kur i këndohen hymne Dionizit, verës e rrushit. Ai det, lufton kundra armiqvet dhe takohet me shqiptaren Jurundinë, së cilës i çfaqet si shqiptar e i tregon se si Sulltani ka nisur ushtëri kundër Shqipërisë, se si ka ardhur të luftojë në vend të vet e si e kuptoi gabimin që ka bërë.

Në bisedë e sipër Jurundina del si e kushërira e Aladinit. Ajo është e armatosur e ka dalur të luftojë, ndaj e pranon atë për shok lufte, duke i treguar dhe historinë e Irenës, që e ka shoqe. Pastaj Jurundina i tregon Aladinit se si ka dalë të kërkojë draguan, Skënderbenë, e merr rast t'i rrëfejë ëndrrën e së ëmës të Skënderbeut para se të lindëte kreshniku, episod ky i marrë nga Barleti.

Si ka treguar dhe për origjinën e lashtë të shqiptarëve prej pellsgëve, ajo vendos bashkë me Aladinin që të shkojnë në Shqipëri për të luftuar kundër turkut.

Trimët ven: Kur afërohen
Shkjypërizës tek u ljenë
Me gëzim të madh gëzohen.
I bekonjën ndër haren
Zogjërat tue fërshëlluar,
Ndepër maljet t'adhuruar. (III, 184)

Në përgjithësi kënga e tretë është plot elementë të eposit kalorsiak e romantik dhe imitime nga «Orlando Furioso» i Ariostos ose «Jerusalemi i çliruar» i Tassos.

Edhe në këngën e katërt veprimet zhvillohen në Shqipëri, ku është dhënë alarmi se po vjen turku dhe shqiptarët nga të katër anët rendin për të mbrojtur vendin. Skënderbeu me kalorës të tjerë shqiptarë përgëzojnë trimëreshën Jurundinë; pranë mbretit është edhe trimi Aladin. Lufta ka karakter të përgjithshëm nacional dhe popullor.

Kuçi, Trepshi Otto e Grudha,
Shalë e Shosh, Shkreli, Kastrati,
Skandërbekut i dërguan
Trimërat që më guxuan. (IV, 28)

K. Serembe i pari i jep luftës kundër pushtimit turk karakter popullor, duke paraqitur mobilizimin e gjithë popullit, ndihmat që jepen në përgatitjen e sulmit kundra turkut, si dhe pjesëmarrjen në luftë të barinjve dhe malësorëve fshatarë:

Ján të besës vullnetarë
Kta barinj e maljësorë,
Ján të kombit roja e parë
Edhe ngrehen si drangorë
Te kushtrimi i Skandërbeut,
Te kushtrimi i Mëmëdheut. (IV, 32)

Duke thënë një të vërtetë historike, poeti përmënd kontributin e luftës së shqiptarëve me Skënderbenë në krye për t'i prerë hovin invazionit turk në Itali. Nga ana tjetër në poemë lufta e Skënderbeut paraqitet nga njera anë si një luftë për shpëtimin e vendit nga turqit dhe nga ana tjetër si një përpjekje për krijimin e një shteti të fuqishëm shqiptar.

I kënakjur marr me mua
Gjith kta trima e as kam nevojë
Pse mba mend, po unë dua
Me bashkime kësi sojë
Themellimin e një Shtet
Për gjithë racën t'ëmën' jet'. (IV, 80)

Në këtë këngë dalin të skicuar mirë një radhë trimash e kapedanësh shqiptarë si Vrana Konti e Moisiu i Dibrës, por mbi të gjithë shkëlqen Skënderbeu:

Zoti i Madhi, ljarta, ë vën
Mbi të gjitha ushtërit.
E kur fjamurin e ngrën
Skandërbeku gjithë fukjit
I ka tashi, se ja dhanë
T'Arbërisë sa Prinët janë. (IV, 108)

Veç trimave të Skënderbeut që kalojnë varg e vistër në këtë këngë si në të dytën këngë të Iliadës, poeti ka paraqitur dhe vajza të reja e të bukura, por mbi të gjitha trimëresha, nga malësitë e Tomorrit, Korça apo Vlora që kanë ardhur «t'i falin gjakun Arbërisë».

Kënga e katërt mbyllet duke e lidhur origjinën e shqiptarëve me ardhjen e Andromakës së Hektorit si skllave në Epir.

Kënga e pestë na shpije në malet e Shqipërisë, ndër stanet, ku barinjte kalojnë një jetë të qetë e të gëzuar, që trazohet vetëm kur u bije ujku ndër dhen. Po kësaj herë qetësinë e prish ardhja e turkut. Jepet alarmi dhe të gjithë armatosen, duke caktuar të parin që do t'i prijë për të pritur turkun që mund të vijë t'u rrëmbejë kopetë.

Plaku bari Rudheci takon Skënderbenë, i cili i fal ca dhurata që ia ka dërguar Ballabani; plaku nuk i pranon ato, ndërsa Skënderbeu i ka dërguar Ballabanit një drapër dhe një parmendë. Ndërkaq Rudheci e lajmëron Skënderbenë se po vijnë turqit dhe trimi i Krujës jep alarmin që të dalin e të presin armikun në Krabë:

Thotë: «Shkon urdhër mbi vores
Sa t'e shtypni Turkjërin
Afër Krabes. Fjalja ë bes!
Ecnì gjith ku vura syn.»
Fjet këndimi për sa janë
Ushtëtorë e kapedhanë. (V, 93)

Lufta ndizet; poeti nxjerr në skenë Tanush Topinë, Lekë Dukagjinin, Milo Shinin, Ballshën dhe prijsa të tjerë, që i dalin para Kara Mahmutit. Del edhe figura e Skënderbeut, që korr turq me shpatën e tij:

Skandërbeku më s'e ruan
Mbasi armiku ra mbë truall:
E tutje shpatën e ljuan,
Ku më fort rreziku u suall.
Copa turku rrotull mbyell
Copa turku ven në kjiell. (V, 114)

Turqit ikin bashkë me Ballabanin dhe shqiptarët këndojnë këngë fitoreje.

Rrethimi i Krujës dhe qëndresa e shqiptarëve përbëjnë brendinë e këngës së gjashtë dhe të shtatë. Që në krye të këngës së gjashtë përshkruhet Kruja si qytet i fortifikuar me mobilizimin e gjithë popullit që jep çdo gjë për të mbrojtur qytetin e për të zbrapsur armikun. Pastaj, duke nxjerrë në pah karakterin partizan të luftës së Skënderbeut, poeti paraqet sulmet e befasishme të Skënderbeut, që ka dalë jashtë mureve të qytetit.

Nga ndeshjet në mes të dy palëve dhe sulmet e shqiptarëve armiku pëson humbje, ndonse, si tregohet në këngën e shtatë, e qëllon fortesën me top. Sulltan Mehmeti i hypur në kalë, vëren sulmin kundra qytetit ku merr pjesë dhe Ballabani. Por shqiptarët luftojnë me heroizëm. Në mbrojtjen e Krujës marrin pjesë vasha e gra, që ndihmojnë luftëtarët duke u sjellur bukë e ujë.

Vasha e gra mbi muret v'an
Mbrojëtarvet për me siellë
Bukën që fukjin e mban.
Mbasi etja ë nj' uljke e piellë
Ndënjën potin bën me ujë
Malj e uthull: «Etin shujë!». (VII, 59)

Skënderbeu ndeshet me Ballabanin dhe në një çast të rrezikshëm ndërhyjnë Milo Shini. Armiqtë shpartallohen e ikin në panik, ndërsa shqiptarët plaçkisin dhe çadrën e Sulltanit.

Pas gëzimit të fitores, Jurundina i lutet Skënderbeut t'i japë leje Milo Shinit të vejë tek Irena e dashur dhe ai e lejon.

Në këngën e tetë jemi në çadrat e Sulltan Mehmetit, në ditën e lindjes së tij. Një vajzë nga Athina ia ka marrë këngës edhe kërcen; është Athinakja që me elemente të mitologjisë i këndon Europës të hypur mbi një dem. Që andej poeti na shpije tek Irena e Milo Shinit, e cila tani, që duket se mbaroi lufta, pret me shpresë të dashurin:

Than se ljufta kish fënuar.
Vasha pjeksën me hadhi
Një kuror' dhafni i nderuar
Trimit që te zëmra i rri
Pse ljufton me Skanderben
E mburojti Mëmëdhen. (VIII, 37)

Po poeti dyshon që lufta të ketë marrë fund. Edhe me të vërtetë ashtu si thotë ai është: lufta s'ka mbaruar, se Sulltani ka nisur për të shtypur Janinën, Sinanin, ish shqiptarin e kthyer mysliman, Gjon Shpatën, të shoqin e Eufrozinës. Këndohet gjatë përçarja e shqiptarëve, që sulltani i ktheu me forcë në myslimanë, dhe historia e dhëmbshme e Eufrozinës.

Në këngën e nëndë, poeti ndjek Milo Shinin, që me lejen e Skënderbeut nis për tek Irena. Udha është e gjatë, por dëshira e zjarritë e trimit për të arritur sa më parë tek e dashura është e papërmbajtur. Si ka mbritur Milo Shini tek Irena, vjen një turk, që ka ikur prej Sulltanit se i ka rrëmbyer e futur në harem të dashurën e vet, Afërditën, në vënd të së cilës i ka falur roben shqiptarë Dilen, por turku e ka liruar atë sa arritën afër Krujës. Në bisedë e sipër Milo Shini e turku flasin për mizoritë e Sulltanit dhe ky i fundit i tregon episodin e Pjetër Shinit, vëllait të Milo Shinit, të cilin Sulltani e vari, mbasi e preu në besë. Me ndonjë ndryshim pa rëndësi episodi është marrë nga rapsodia popullore me të njëjtin emër.

Kënga e nëndë shquan për momente të goditura, siç janë veçanërisht skenat e gjalla të kremtimit të ditës së Rusalevet.

Në këngën e dhjetë përshkruhen qejfet e Sulltanit në harem me greken Afërditë. I dehur, pas dashurisë me të, bie në gjumë, por sheh ëndrra të frikshme. Zgjohet dhe mendimet i shkojnë tek Skënderbeu. Jep urdhër të përgatitet ushtria para së cilës tmerrohen kafshë e egërsira, veç shqiptarët jo, që me Skënderbenë në krye, e presin me trimëri. Sulltani i ka dhënë urdhër Ballabanit që të zaptojë gjallë vdekur gjer nesër Krujën, por Krujën e rrethuar e mbron Topia. Be-teja është e rreptë e shqiptarët qëndrojnë si burrat.

Ljufta zin me rrebtësirë,
Gjegjën armat që përplasën
Duke dhën' mortën e ngryrë.
Shum, pllajosur, tokën ngasën.
Mbجاتu ngrëhen për guxuar
Nj' atër her' duke ljuftuar. (X, 76)

E Shkjyptart' nga jatra anë
 Duke rrahur rrin si murë,
 Rrin si arzen që turrin mbanë
 T'Buenës kurna trunge e gurë
 Derra e kuel e kje të mbytur
 Dredhë e kjellën tue grabitur. (X, 79).

Tuke rrokur patrizhana,
 Shpata, cabja edhe mahjera
 T'Arbëris trimat, si Zana,
 Fjaturonjën si skyftera.
 E të fortën këmbë e vënë
 Te ku Turkjët vendin ljenë. (X, 95)

Gjatë betejës vritet Mirahori; koka e tij me urdhër të Topisë vihet në një hu. Turqit i zë paniku e ikin «si lepujt», duke lënë pas të plagosurit që thërresën e s'i ndjen kush.

Sa ra Hoxha Mirahore
 Turkjërat u frikësuan
 Posi ljepura të gjorë
 Iktin. Armat i shtëlluan,
 Dhe plahosurit ljërien.
 Kta thërresën. Kush i ndien? (X, 133)

Në këngën e XI mpleksen elemente mitologjike me elemente historike, elemente të paganizmit me ato të krishterimit. Veprimi zhvillohet në bjeshkët e Kidhnës ku kanë ikur gra, fëmijë e pleq për t'i shpëtuar turkut. Atje në bjeshkë, në prani të trimit Aladin e të orës Jurundinë, të gjithë ia marrin valles, se është ditë feste. I këndohen këngë diellit e verës, kur del Jurundina e, mbasi i lajmëron shqipëtarët se s'është kohë këngësh me armikun tek dera, niset e gjen Skënderbenë. E merr atë për dore dhe e shpie në vende të ndryshme, midis së tjerash në breg të një liqeni, ku ziejnë ujrat e digjen shpirtrat e atyre që kanë tradhëtuar atdheun.

E një bukurie të veçantë është kënga e dymbëdhjetë që lartëson figurën e Jurundinës. Duke ecur madhështore, si burrëreshë me armë në dorë, e nderuar nga gratë e vashat, ajo i turret një ariu që del nga shpella dhe e ndjek pas. Aladini do ta ndalojë nga rreziku e, si vonon, niset të shohë ç'ka ndodhur, por përpara i del një turk, lufton me të e plagoset për vdekje. Jurundina e dëgjon bririn e Aladinit e rend në ndihmë. Në çastet e fundit trimi i thotë:

«Motër, u vura kurorë
 Ljuljash gjaku njo në ball:
 Nusja ngryn posi dëborë,
 E në gji më vu me mallë,
 Posi tufa me bubukja
 Katër varra buzëkukja.

Nusëja më solli paljë
 Tri shyxhet në krahënuar
 E ndër supet katër maljë

Shtyze: Thell më kan shpuar.
 Krushk e nun të vrarët kjén
 Që mbë rreth mbullonjën dhén» (XII 75-76).

Duke ndjekur turqit për t'i marrë hakun Aladinit, Jurundina takon udhës Preng Gjinin, shokun e tij të armëve dhe i jep lajmin e hidhur. Tani që ka humbur dhe Aladinin, ajo lufton trimërisht e ndezur nga urrejtja, kur sheh mizoritë e turqve që vrasin e presin njerës pa faj, shnderojnë vashat e torturojnë pleqtë. Ndërsa sulet për të shpëtuar një grup grash e pleqsh që torturohen prej turqve, e godisin shigjetat e armikut e bie e vdekur.

E dy shtyza fjuturonjën
 Duke u dredhur; drekj e zënë;
 Jurundinën dëpërtonjën
 E pa frymëzën e ljënë,
 E për frigë e për çudhi
 Turkjëria e zbetun rri. (XII, 168)

Në këngën e trembëdhjetë paraqitet tragjike gjendja e Shqipërisë në çastin kur veç Krujës së rrethuar prej kohësh, fuqi të reja turke kanë ardhur në Dibër dhe në Janinë. Shqiponja e shqetësuar e kërkon Skënderbenë an'e mba'në, po nuk e gjen; ai ka zënë sigurisht ndonjë pritë të zakonshme në rrethet e Krujës:

Dielli delj e te Kastrati
 Skënderbeu po së shihet.
 Te ku fjë pa ngar ë shtrati.
 Fjasën gjith e gjë së dihet.
 Kjan Shkjiptonja: «E shkreta u!
 Skanderbeku s'ë këtu!» (XIII, 1)

E kërkon dhe Kruja trimin e vet, e ndërsa ai s'është kthyer edhe, dalin në skenë figura të ndryshme si ajo e Dukagjinit, Preng Gjokës nga Kaçinari, e burrash të tjerë që luftojnë me turqit. Skënderbeu ndërkaq kthehet në Krujë, por udhës takon Gjon Krabën, atë tradhëtarin që hodhi qenin në pusin e Sfetigradit, e i rrëfëhet tani se si nga lakmia për pasuri u bë tradhëtar. Atë e ka mallkuar e ëma, kur i shpuri arin e armikut, dhe ky mallkim e zuri: natën ndrrohet në ujk dhe u vërsulet turqvet, kurse ditën bëhet prapë njeri. Gjon Krabën tani e mundon ndërgegja për krimin që ka kryer ndaj atdheut dhe Skënderbeu e fal.

Kënga e katërbëdhjetë na paraqet mbledhjen e princërve shqiptarë, ku Skënderbeu jep udhëzime për një sulm të papritur mbi çadrat e armikut. Dhe trimat ashtu bënë: armiku u zu në befasi, çadrat e tij morën flakë, ndërsa Moisiu vret prijsin turk Asan be Vërxheshtin.

Shqiptarët bëjnë kërdrinë mbi armikun duke i prerë hovin Ballabanit.

E prandana sa më janë
 Arbëresh, me rrebtësi,
 Më të madhe, anë e mb'anë
 Shtyhen, edhe venë fukjit
 Ballabanin për ndaluar
 Sulmin që tue pregatuar. (XIV, 79).

Në mes të këngës del në skenë Milo Shini që mendon për Irenën e tij. Poeti përmes një digresioni na tregon se si Irena, kur dëgjoi lajmin e vrasjes së mikeshës së saj, Jurundinës, i paska hipur kalit e qënka nisur ta kërkojë. Fjala është hapur sikur paska rënë në lumin e Matit dhe është mbytur, ndërsa Milo Shini e kërkon dhe e kërkon. Por Irena nuk ka vdekur; Milo Shini e lajmërojnë se ajo është gjallë dhe ai, duke mos u mbajtur nga gëzimi, kujton me respekt Jurundinën që, si Orë e maleve shqiptare, ia solli Irenën prapë. Rreth Irenës bëhet një përleshje e rreptë në mes të turqvet e shqiptarëve dhe, pasi ka shpëtuar Irena me Milo Shinin, armiqtë kanë rrethuar Dukagjinin; por vjen mëngjesi dhe ndeshja pushon.

Në këngën e pesëmbëdhjetë gjëndemi në kampin armik, ku turqit, me urdhërin e Sulltan Mehmetit, po pregatisin ekzekutimin e një turku, që nuk e ndihmoi sa duhet Mirahorin dhe e la të vritet. Pas kësaj ngjarje, që zhvillohet rreth murevet të Krujës së rrethuar, Sulltani jep urdhër të rifillojë sulmi kundra qytetit. I pari në sulm është Ballabani me jeniçerët e tij. Mbrojtësit e qytetit me Topinë në krye i presin hovin armikut:

E Shklyptarërat mburrohen
E me turr përpara vén
Edhe Turkjërat harrohen
Se Sulltani i madh i vrën.
Ovi i armikut është i prerë
Kruja e fortë bëhu nderë! (XV, 42.)

Në luftë si dhe në këngën e katërt marrin pjesë edhe gratë me ç'të mundin, për t'i ndaluar armiqtë që të hidhen mbrenda në qytet:

Nusja e Darës me dy dorë
Ngren supatën edhe ndanë
Elmë e kok' njij ushtëtorë
Që nga shkalla shpatën ngjanë
E gatohet të këcenjë
Ndër bedhenat sa të prenjë. (XV, 52)

Midis grave ka dhe nga ato, që, si Dilja e Zefit, japin jetën trimërisht.

Duke përshkruar heroizmin e shqiptarëve, poeti kallëzon episode si ai i Kolë Hormovës, të cilin turqit e djegin të gjallë.

Të rrethuarit i ndihmojnë nga jashtë veprimet e Skënderbeut që e detyrojnë armikun të tërhiqet.

Kënga mbyllet me valle e lule, simbol i gëzimit edhe për një fitore tjetër.

Kënga e gjashtëmbëdhjetë përmban ngjarjen e shpatës, që Skënderbeu i ka dërguar si dhuratë Sulltan Mehmetit. Ky me të gjithë trimat e tij nuk ka mundur ta përdorë dot dhe kujton se Skënderbeu nuk i ka dërguar shpatën e tij të vërtetë; prandaj thërret një çerkez, i jep shpatën edhe e nis për te Skënderbeu, duke i premtuar këtij ç'të dojë, pasuri, robër e gra të bukura, në vend të shpatës së vërtetë të Skënderbeut. Kur e lajmërojnë Skënderbenë për ardhjen e çerkezit, ai përgjigjet në thenien e njohur që përmend Barleti:

«Shpatën time ja dërgova
Po dhe krahun s'i dhurova» (XVI, 36)

Çerkezi kthehet e i sjell Sulltanit ç'i tha Skënderbeu. Ai tërbohet nga zëmërimi e mënt e vari, po të mos kish marrë vesh se çerkezi rrugës ishte ndeshur me viganë e kish shpëtuar greken e bukur Afërditë nga duart e tyre. Më poshtë poeti përshkruan gjatë ndeshje të ndryshme në mes trimash shqiptarë e turq, duke nxjerrë në skenë Skënderbe-në, Milo Shinin, Dukagjinin e të tjerë.

Kënga e shtatëmbëdhjetë nis me lutjet që u bën Irena zogjvet e erës për t'i treguar në kanë parë Milo Shinin, që e sheh në ëndërr, e pret e s'po i vjen. Vetëm korbi i zi i përgjigjet:

Milo Shini, më vjen kekj,
Kje plahosur për vëdekj. (XVII, 69)

Poeti pastaj përshkruan Irenën në dritare, që i bëhet sikur dëgjon një këngë të Milit të saj, fjalët e së cilës i kujtojnë ditët e lumtura të dashurisë, premtimet dhe ëndërrën e bukur të martesës. Irena mar-tohet me Milin e vdekur, se vdes dhe ajo. Një çobankë rrëfen çudi-në që ka parë me sytë e saj: bashkimin e dy të rinjve. Poeti e mbyll këngën duke marrë pjesë në ngjarjen e mallëngjyer të vdekjes së Ire-nës dhe të Milit.

Në këngën e tetëmbëdhjetë poeti na tregon se Sulltan Mehmeti i ka pakësuar forcat rreth Krujës e se ka vajtur për të marrë Durrësin nga venecianët, për t'i prerë kështu udhën e ndihmavet Skënderbeut. Prijës i ushtrisë për të marrë Durrësin është emëruar Ballabani. Turqit janë të përgatitur, po edhe ana shqiptare nuk flë; për të mbrojtur Durrësin kanë ardhur nga të katër anët e Shqipërisë. Spikat në këtë këngë dëshira e lebërve për të marrë gjak.

Jan Llabët. T'ashpëruem
Kekj Davlletin e mallkonjën:
E me sy të zgurdhulluem
Mir dica armat shtrëngonjën
Ottomanët për me therë.
Kekje a rrotull ndihet erë. (XVIII, 44)

Poeti harron se në fillim desh të fliste për mbrojtjen e Durrësit, zgjatet e stërgjatet për të na treguar episode të ndryshme heroizmi, ndeshje luftëtarësh të ndryshëm me armiq, mizoritë e armikut ndër shqiptarët e zënë rob. Kënga mbyllet prapë duke na shpënë rreth Durrësit, ku disa luftëtarë lebër takojnë një plakë shqiptare që u ep ujë nga bucelja e saj, se janë djegur etje.

Kënga e nëndëmbëdhjetë s'ka një veprim unik; auktori na shpi-je nga një episod në tjetrin, duke vënë të luftojnë heronj të ndryshëm kundër turqëvet, duke na nxjerrë në skenë trima si Matranga, Krispi, ndër të cilët shkëlqen si gjithnjë trimëria e Skënderbeut. Në këngën e njëzetë forcat shqiptare po përgatiten për betejë; Skënderbeu bën planin, duke vënë në të mëngjër Dukagjinin dhe Perllatin, në të djathtë Moisi Golemin. Nga ana tjetër është rreshtuar armiku. Beteja nis e ashpër dhe e përgjakshme duke u dhënë fitoren herë shqiptarëve herë Turqëvet. Një duel i rreptë dhe i gjatë zhvillohet në mes të Ballabanit dhe të Dukagjinit.

Në fillim fitorja i buzëqesh Dukagjinit, por Ballabani e plagos për vdekje me një shigjetë. Dhe rreth trupit të Dukagjinit, si rreth trupave të heronive homerikë, zhvillohen përleshje për të rrëmbyer

armët e për të shpëtuar trupin. Ndërhyn Perllati që ndalon turqit, ndërsa Dukagjini vdes duke i dhënë përshëndetjen e fundit mëmëdheut.

Kur tëhiljte Duka Gjini,
Miku i pari i Skandërbeut,
Sit' e zez si kokja ullini
Than të falja Mëmëdheut. (XX, 91.)

Në këtë moment kritik ndërhyn Skënderbeu për të shpëtuar situatën dhe kënga mbaron pa përfunduar beteja që vazhdon të nesërmen që në mëngjes, si përshkruhet në këngën e njëzetënjëtë.

Tani Ballabani riorganizon forcat e ka shpresë për fitore, meqë është vrarë dhe Dukagjini, por ndërhyn Perllati përsëri. Ballabani qëndron dhe nxit ushtarët turq të qëndrojnë dhe ata. Autori lajthit dhe nxjerr prapë të gjallë në skenë Dukagjinin, bashkë me prijsa të tjerë si Kont Urani, Moisiu, që lufton në anën e detit se edhe jemi në mbrojtjen e Durrësit.

Duke parë nga larg zhvillimin e betejës, Ballabani dëshpërohet për humbjet e shumta që pëson ushtria turke. Aqë më tepër ndërhyrja e Skënderbeut, fut edhe kësaj here tmerrin në radhët armike, duke i vënë ata përpara nga ana e detit.

Dridhen turkjit, nën të mbajtat
Të shkëllkjiera, se tëmeri
Kekj i shkundën; ndër të çajtat
Radha ikën, humbet nderi,
E dëgjohen ullurime,
Ullurime edhe rëkime. (XXI, 88.)

Ballabani e ka pisk, kërkon ndihmë, po s'ka si t'i vijë, kurse trimat shqiptarë brohorasin për kryetrimin Skënderbe, e sulen duke vrarë pa mëshirë armiqtë.

«Rroftë Skandri ljuftëtarë!»
Gjithë thërresën trimanarët,
E versuljen duke vrarë
Turkjërat që zëmërrarët
Nuk jan mbasi ata shpresonjën
Tek Allahu e po duronjën. (XXI, 121).

Me nota të gëzuara fillon kënga XXII e poeti merr pjesë në gëzimin e fitores së shqiptarëve mbi turqit:

More vjershët flluturoni
Dellanishaç si llohjë
Edhe a rrotullas shikoni,
Tue kënduar me shum haré,
Si iknjën turkjerat të mjerë
Posi ljepur veshëngrërë. (XXII, 1)

Bukur ka paraqitur poeti në këtë këngë ikjen e turqve me «kryekatilin» Sulltan Mehmetin në krye, duke lënë pas «shumë copa të

ushtris», si dhe dëmet që pësojnë ata nga pusitë e papritura të shqiptarëve të cilët i ndjekin e s'i lënë të qetë për asnjë çast:

Edhe bënjen një kërdhi
Nj'atër her' që nuk u pa;
Gjegjet rrotull trihjimi,
Si tërmeku kurna ra,
Edhe turkjit janë të vrarë,
Posi delja e jo si ushtarë.

... Edhe suljen posi demë,
Kush me topën e me gurë,
Kush me kiza, kosa e drurë.

Shumë turkjëra përndahen
Ndëpër pyljat për shpëtuar;
Vëndasit a prapa i mbahen
Me langorët tuke i gjuar,
E ja arrenjen edhe i vrasën,
Më mbi dhe së kan të ngasën. (XXII, 21-23.)

Edhe në pyje, ku janë futur me shpresë që t'u shpëtojnë ndjekjeve, turqit gjejnë vdekjen, se shqiptarët u vënë zjarrin pyjeve.

Në këtë këngë, për të dhënë një kuadër të ri të mizorive të armikut, poeti rrëfen episodin e shnderimit të një vashe shqiptare, që turqit e kanë hasur në rrugë me të ëmën. Por turku e paguan krimin e tij: qymyrxhinjtë shqiptarë japin alarmin në pyll, dalin të kërkojnë vashën e grabitur, gjejnë turkun, e kapin, e lidhin dhe e torturojnë:

Mbjattu turkun burrat zën
Mirë e ljidhnjen këmë e duar
Kryeposhtë të vjerrë e vën
Te një deg, tuke e mallkuar.
Puthën mbesën Nusha e kjan;
Cubi i vrëret forën mban.

Thernjen cubin posi thy
Burrat: vjerrun e ljerenjën.
E nga buza gjak të zi
Jargë e shkumë a poshta venjën;.. (XXII 72, 75.)

Duke lënë «cubin» mish për korbat, trimat ikin të gjejnë gratë që u sjellin bukë. Rrugës takojnë një shqiptarkë, që qan mbi trupin e të shoqit, të cilit i kanë prerë duart turqit:

E të shkretës bie zalji
Se dy dór' të pulzi prerë
Trollit jan nën bar e hi
Pllot me gjak. O burr' i mjerë!
Grat tokës nuk i ljenë
Nd'skamandilj copat i vënë. (XXII, 78)

Turq të vrarë e të plagosur, katandisen si mos më keq, të tjerë që ikin nga sytë këmbët, të ndjekur nga shqiptarët, robër të lodhur e të cfilitur, paraqet poeti në këtë këngë, por nuk është prishur e tërë ushtria turke; njisitë e Ballabanit kanë qëndruar në rregull, ata që kanë dashur të ikin, ai i ka vrarë barbarisht:

Për së pari ndonjëri
Doj të ikte i marrë nga dre,
Po i Badherës burri i ri
Vet i vrau si drangolje
Edhe krerat mbi një dru
Si mbësin për gjithë i vu. (XXII, 97)

Ballabani nga do që kalon djeg e pret:

Nga do shkonjën zjarrin vën
Shpivët, edhe tymi ngrëhet
Posi ret që kjiellin zën
Kur në dimen moti vehet
Mbë shi e maljet mir së shihen,
E ndër shpellat ulkjit shtihen. (XXII, 100.)

Si arrin në Dibër të Madhe, Ballabani i afrohet një stani: aty, si bari që ka qënë, i zgjohen kujtime të së kaluarës, i kujtohet dhe arapka që dashuroi, ashtu si na e paraqiti poeti në fillim të poemës. Përmëndet nga ëndërrat dhe pret praparojën, po ajo nuk duket; e kupton se e ka shkatrruar Skënderbeu:

Ballabani â i zemëruem
Praparoja s'as butthoet.
Mos ka kjenë e copëtuem.
Se q'â Skandri së harrohet. (XXII, 109)

Poeti e mbyll këngën duke iu drejtuar Ballabanit:

Ballaban, ty motin bier,
Motin bier, o tradhitarë,
Mbasi Arapët kjenë të thyer,
Kjenë të rrahur, kjenë të vrarë,
Nga it kombi, nga Shkjiptarët. (XXII, 112.)

Kënga e zogjvet dhe tingujt e këmbanëvet që bien me hare për fitoren, hapin të njëzetetretën këngë të poemës. Shqiptarët mendojnë të varrosin me nderime të rënët dhe poeti gjen rast të përshkruajë hollësisht varrimin e një heroi, Bozdarit, emrin e të cilit e mori nga eposi legjendar arbëresh. Trima si Bozdari, që bien për atdhe, mbeten të pavdekshëm, ashtu si e këndon një vashë:

Fundit klan një vashë e hollë
Edhe ljet i bin nga syt,
Kjan vasha fakjemollë
E shkëlqjen për bukurit:
«More trim, na të kuljtomi,
Jetë e mot na të nderomi. (XXIII, 30)

Nga skena e varrimit të Bozdarit, poeti hidhet të na përshkruajë gostinë e Moisi Golemit me shokë, prijasa shqiptarë, që pinë e këndojnë për fitoren. Trimat ua marrin këngëvet të eposit romantik të mesjetës; ata i venë në lahutë trimëritë e Orlandit. Pastaj organizojnë një gjah, gjithnjë duke imituar poeti eposin romantik, si në «Orlando Furioso» të Ariostos. Hasin në pyll një kaproll, duke e ndjekur trimat arrijnë gjer në Valkal, ku ndeshin Ballabanin. Moisiu e biri i Badherës janë përballë njëri-tjetrit:

Fjet e kjeshën Ballabani
I Badherëz ljeshëzi.
Armën nxier Mosè Dibrani
Edhe e nguljën me fukjië
Trollit thyrret mixorë:
«Pallën ty nga je me dorë!» (XXIII, 104).

Ballabani ka kërkuar të jetë në besë e të mos luftojnë. Me ndërhyrjen e Radavanit sikur bëhet një armëpushim. Është pregatitur kaprolli për të ngrënë e në këngën XXIV Ballabani paraqitet i ulur bashkë me shqiptarët, që e pranuan në bukë si mik në besë:

Se ç'e madhe fisniki,
Se çë besë e pjot me ndërë
Së të lashtës Shkqipëri!
Vremi si trimat të vlerë
Ballabanin nuk e shanjën
Edhe eshtrat nuk i çanjën. (XXIV, 10.)

Aty në bukë Ballabani takon shokë shqiptarë të fëminisë dhe kujton me ta të kaluarën e tij dhe u propozon shqiptarëvet që të lidhen me Sulltanin se shpëtimi i Shqipërisë, si vend i vogël, thotë ai, do të jetë lidhja me Turqinë.

Mëmëdheu ë i vogëlj shumë,
Nuk i sosën trimëria;
Ka përkjarkj armikj pa gjumë.
Kekj e vogël Arbëria
Mund të mbrohet me Turkjin
Që ka forcën e fukjin. (XXIV, 19.)

Një shqiptar i jep Ballabanit aty për aty përgjigjen e merituar:

Shkqipëria e vogëlj s'ë;
Ësht e fortë, e fortë shumë
Edhe udhat kurr ja ljë
Armikjëvet. Tomori i ljumë,
Me të vjetrit Perëndi
Edhe trimat pjot fukji.

Po kështu kuptohet mirë
Si ju rrahtim, si ju vramë,
Si Sulltanëvet pjot mixirë
Hera shumë krahët u pamë.

Nga ne iktin tuke kjarë
Me visirë e pashallarë.

Besa ë forca e ndera jonë,
Se na fjaljën së harromi,
Fjaljën mbami mot e monë.
Kjoftë rrezik! S'e ndikuromi.
Esht' këjo një buljëri
Që ngë gjëndet në Skjeni. (XXIV, 24, 26, 27)

Mbaron afati i kohës kur e kanë marrë në besë, Ballabani niset dhe fton për në kampin turk prijsat shqiptarë me Mosinë në krye. Ata venë, por tradhëtari mbetet tradhëtar, i ha në besë: në gjumë i lidh dhe ia dorëzon Sulltanit:

... Të ljidhur, kambë e duar,
Ballabani punëzi
Dërgoj trimat të llëvdhuar
Muhametit në Turkji.
Në Stamboll të mjerët vanë,
Më s'u duktin, më s'u panë. (XXIV, 130.)

Kënga e njëzetepestë, që është edhe kënga e fundit të poemës, nis me zëmërimin e Skënderbeut ndaj pabesisë së Ballabanit.

Skanderbeku mendëgjerë
E vren shpatën me meri
Mbas solli koha e mjerë
Tek e forta Shkqipëri
Si një mjegull kekj e ngryrë
Si një frikë pak e mirë. (XXV, 5.)

Ballabani tani kthehet me fuqi të madhe e me shpresë se do ta mposhtë qëndresën e Skënderbeut që ka humbur trimat më të mirë. Për t'ia arritur këtij qëllimi tradhëtari përdor çdo mjet. Jo më kot poeti tregon këtu episodin e takimit të Ballabanit me një plak shqiptar dhe përpjekjet e tij për ta blerë me para këtë të fundit e për ta bërë spiun të Turqisë. Por shqiptari s'shitet, dhe «pjakarushi» i jep një mësim të mirë Judës, duke ia flakur në sy kuletën dhe urrejtjen:

Nxyer kulletën nga kushalli
Edhe pjakëthit ja ndënë.
«Kurr për arin më zu malli
Pjaku thotë e fakjen vrënë —:
«Kam të vë litar te xerku,
Pra si Judha, o birith derku?» (XXV, 22.)

Si nuk i eci me plakun, Ballabani niset kundër Skënderbeut, duke ëndërruar ta vrasë atë e të fitojë nam e pozitë pranë Sulltanit.

Përballë turqve që, të prirë nga Ballabani, «mortën kërkojnë», qëndron madhështor Skënderbeu, hipur mbi kalë:

Hypën Skandëri kaljuar,
Duket yllë me zjarrë e arë,

Duket një yll i tëmeruar
 Që mbi dhe shkon për me vrarë;
 Shpata shkundet e dëgjohet
 Trëndëllim që së harrohet. (XXV, 46)

Kur shkon Skënderbeu dridhet dheu e lëshojnë shkëndi gurët ku shkel këmba e kalit të tij.

Mbasi ka treguar përpjekjen e Skënderbeut që rend për të shpëtuar ç'mund nga zjarri që i ka vënë armiku vendit, poeti e paraqet heronë në një çast armëpushimi, në shtëpi, pranë së shoqes e të birit, ashtu si bën Homeri në Iliadë, kur na vë përpara Hektorin e Andromakën me të birin. Por ditët që «gëzon nusen e re» dhe djalin nuk zgjasin shumë, lufta ndizet përsëri e shqiptarët shkojnë duke kënduar:

«Rroftit Kruja! Me hare,
 Burra, fjamuri vallon!
 E bekonjën kjiell e dhe;
 Era e puthën e gëzon
 Përsë e ngukjën posi agim,
 Posi gjaku shtun nga trimi. (XXV, 76).

Kënga vazhdon me skena të një bukurie të rrallë epike, ku përshkruhen momente nga heroizmi i shqiptarëve që s'lenë të poshtërohet flamuri i tyre.

Gjatë betejës turqit thyhen keqas dhe Skënderbeu zë të gjallë Ballabanin, të cilin, si e tregon dhe poezia popullore, e lidh, i pret veshin dhe e ngarkon si gomar me flamujt e fitores. Burra e gra e shajnë dhe e përbuzin tradhëtarin:

Afër muret kur afrohen
 Trimat, daljën burra e gra,
 Ballabanit i ljëshohen
 Me të shara të mbëdhá
 Ca me shkopë e gjerdhes hurë,
 Ca me urë, e ca me gurë. (XXV, 148).

Në prani të Skënderbeut vazhdojnë këngët e vallet e gravet, që, si e kanë vënë përpara Ballabanin, e tallin e shpotisin, duke i kujtuar të kaluarën dhe tradhëtinë, pabesinë ndaj Moisiut me shokë në Valkal.

Kënga dhe vepra mbyllet me atmosferën festive të fitores, të mbushur plot brohoritje për Skënderbenë dhe me një apostrofë drejtuar Tiranës.

Më shumë se çdo këngë tjetër, kënga e XXV ka një farë uniteti dhe përmes momentesh të goditura vë në pah karakterin popullor të luftës së Skënderbeut.

Kjo është një nga meritat e poemës, që përbën një përpjekje nga ana e autorit për të paraqitur figurën dhe gjer diku epokën e Skënderbeut.

RESUME

LE POEME DE COSIMO SEREMBE «LES CHANTS DE KRUJE»

Cosimo Serembe, poète et studieux des Albanais d'Italie, en suivant une tradition connue pour notre littérature de la Renaissance, a mis au centre de son long poème «Les chants de Kruje». Il s'agit d'événements tirés du XV^e siècle, notamment de la résistance héroïque des Albanais devant les murs de Kruje, où avait mis le siège le sultan Mehmed II.

Serembe donne un caractère populaire à la guerre soutenue par notre peuple sous Skanderbeg. Il y fait état de la participation active des combattants de tout le pays à défendre Kruje.

A l'appel de Skanderbeg répondent Guègues et Tosques albanais, des bergers qui abandonnent leurs troupeaux, vieux et jeunes, femmes et nubiles. Tous font preuve d'un héroïsme sans précédent.

La figure centrale de sa production est celle de Skanderbeg, qui se fait distinguer pour sa vaillance et sa sagesse. Il est le symbole de l'union et de l'héroïsme du peuple albanais. Autour de lui sont de véritables héros, tels le Comte Vrana, Thopia, Lek Dukagjini, Zaharia, et d'autres, ainsi que des héros créés par le poète ou empruntés au folklore albanais, tels Milo Shini et d'autres.

La pièce a un caractère épique chevaleresque. Ne lui manquent non plus des instants lyriques et des idylles, comme celui de l'amour de Milo Shini avec Irène, qui aboutit tragiquement, car le pays passe une véritable tragédie.

Au point de vue des sources, l'auteur suit notamment Marin Barleci. Ne pouvant pas échapper à son influence, dans le poème souvent la guerre de Skanderbeg assume des nuances religieuses.

«Les chants de Kruje», d'après la note que le poète a mis à la fin, ont été terminés le 22 décembre 1937.

Le poème maintient ses liens avec la source de la poésie des Albanais d'Italie. Les parties, où l'on ressent l'esprit de cette poésie, sont des plus réussies. On ressent en même temps l'influence de l'épopée homérique et chevaleresque, celui de Le Tasse et l'Arioste.

La poème, malgré les faiblesses qu'il offre comme composition, malgré une certaine prolixité et des digressions trop fréquente, n'en offre pas moins un grand intérêt, du fait qu'il brosse un ample tableau de l'histoire albanaise au XV^e siècle.